



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE PËR TË
DREJTAT DHE MBROJTJEN E
FËMIJËS

QENDRA E PARANDALIMIT TË
KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË
RINJVE

Nr. _____ Prot.

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AGJENCISË SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS
DHE

QENDRËS SË PARANDALIMIT TË KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË RINJVE
(QPKMR)

“Për

**forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve në
konflikt me ligjin”**

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, (Në vijim referuar si ASHMDF) përfaqësuar nga Kryetar znj. Alma Tandili me adresë “Rruga e Durrësit, Nr. 83, Tiranë, dhe e-mail: Info@femijet.gov.al.

dhe

Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (më poshtë “QPKMR”), përfaqësuar nga Znj. Klaudia Hasanllari, me adresë Rr. Frederik Shiroka, Godina Nr. 8, kati i IV, Tiranë dhe e-mail: qpkmr@drejtesia.gov.al.

Lidhin Marrëveshjen e Bashkëpunimit

Duke qenë se Palët:

Vlerësojnë rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional si vendimtar në arritjen e objektivave të përbashkëta për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve në konflikt me ligjin bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, në zbatim të kuadrit ligjor për mbrojtjen e fëmijës, të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026 dhe Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit 2022- 2026;

Konstatojnë se vitet e fundit numri i të miturve në konflikt me ligjin ka ardhur në rritje dhe veçanërisht numri i të miturve përsëritës, dinamikat e menaxhimit të tyre janë të ndryshme dhe si rrjedhojë nevoja për bashkëpunim dhe rritje të kapacitetit të stafeve është gjithmonë e më e lartë;

Konfirmojnë se mbrojtja e fëmijëve në konflikt me ligjin është e pamjaftueshme vetëm nëpërmjet përcaktimeve të parashikuara në kuadrin ligjor për të dhënë gjithë përgjegjet dhe garancitë e kërkuara për shkak të dinamikës së rreziqeve të përfshirjes së fëmijëve në aktivitete kriminale;

Vlerësojmë mbrojtjen që legjislacioni shqiptar në fuqi i jep fëmijëve në konflikt me ligjin përfshirë edhe fëmijet nën moshën e përgjegjësisë penale, që trajtohen brenda sistemit të mbrojtjes së fëmijës si kategori e fëmijëve në nevojë për mbrojtje të posacme;

Afirmojnë vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshjeje për të përmbushur angazhimet e ndërmarra në kuadër të instrumenteve kombëtarë, dhe veçanërisht për të përmbushur nevojën gjithnjë e më shumë në rritje për trajnime dhe forcim të kapaciteteve për profesionistët që trajtojnë këto raste;

Bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në vijim e quajtur Marrëveshje.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet në ligjin nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, ligjin nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, VKM Nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e

masave të mbrojtjes”, VKM Nr. 353, datë 12.6.2018 ” Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive administrative”, VKM Nr. 635, datë 26.10.2018 “Për veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijën nën moshën për përgjegjësi penale, që dyshohet apo ka kryer veprë penale”, Udhëzimin Nr.262, datë 26.05.2021 “Për miratimin e metodologjisë së punës për menaxhimin e rastit të fëmijëve në konflikt me ligjin nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës”, Udhëzimin e përbashkët Nr.650, datë 13.09.2019 “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për përzgjedhjen e përfaqësuesve procedural për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal”.

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve në konflikt me ligjin.

Neni 2

Objekti

Kjo marrëveshje përcakton mënyrën e bashkëpunimit dhe bashkërendimit brenda kompetencave ligjore të palëve sipas veprimtarisë përkatëse për të arritur qëllimet e përcaktuara në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Detyrat e palëve

1. Në bazë dhe për zbatim të kësaj Marrëveshjeje, Palët angazhohen të përmbushin detyrat si vijon:
 - a) të angazhohen në krijimin e një bashkëpunimi ndërinstitucional duke përfshirë edhe aktorë të tjerë për garantimin e mbrojtjes së fëmijëve në konflikt me ligjin;
 - b) të koordinohen në përmbushjen e të gjitha aktiviteteve të përbashkëta që janë përfshirë në kuadër të zbatimit të objektivit specifik III.4 të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026 “*Drejtësi miqësore për fëmijët*” për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin”, si dhe në zbatim të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e Drejtësisë për të Miturit 2022- 2026, si dhe çdo aktiviteti tjetër që dakordësohet nga palët;
 - c) të konsultohen, informojnë dhe t’i raportojnë njëra-tjetrës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre për rritjen e kapaciteteve të profesionistëve të vijës së parë si dhe në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin që të sigurohet mbrojtja e fëmijës dhe përmbushja korrekte e detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi;

- d) të angazhohen në organizimin e fushatave ndërgjegjësuese, trajnimeve, konferencave dhe publikimeve të materialeve edukative, me kontribut të dakordësuar të të dy palëve, lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në konflikt me ligjin;
- e) të bashkëpunojnë me anë të grupeve të punës për të dhënë mendim në hartimin e udhëzimeve për ndërtimin e instrumenteve ligjore dhe teknike për mbrojtjen e fëmijëve në konflikt me ligjin;
- f) të bashkëpunojnë në identifikimin dhe listimin e bashkive, ku Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës dhe QPKMR kanë menaxhuar raste të fëmijëve në konflikt me ligjin për hartimin e kalendarit të aktiviteteve të përbashkëta duke përcaktuar temat, bashkitë dhe afatet kohore;
- g) të krijojnë ura bashkëpunimi për të siguruar një informim aktiv nëpërmjet publikimit në faqet zyrtare të mediave sociale të palëve dhe në mediat audio-vizive;

të organizojnë, të paktën dy herë në vit, takime të përbashkëta mes titullarëve apo përfaqësuesve për diskutime mbi ecurinë, vazhdimësinë dhe plotësimin e objektivave të kësaj Marrëveshjeje dhe Planit të Përbashkët të Punës, sipas formatit të aneksit nr. 1., bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje (Aneks 1), ose në çdo rast që çmohet e nevojshme.

- 2. Palët mbeten përgjegjëse të zhvillojnë aktivitete edhe në mënyrë të pavarur, në kuadër të përmbushjes së objektivave të tyre strategjike.

Neni 4

Shkëmbimi i informacionit

- 1. Palët, në dijëni të përgjegjësive të tyre ligjore, zotohen të respektojnë dhe të ruajnë etikën profesionale dhe konfidencialitetin e informacionit për secilin nga rastet objekt të bashkëpunimit midis tyre.
- 2. Në qoftë se nevojitet, në funksion të interesit më të lartë të fëmijës, njëra palë mund t'i kalojë informacionet e përfituara mbi personat subjekt i kësaj Marrëveshjeje palëve të treta, duke njoftuar/sqaruar paraprakisht me e-mail apo shkresë palën tjetër nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me këtë veprim.
- 3. Shkëmbimi i informacionit midis Palëve do të bëhet me mjete të sigurta komunikimi me qëllim ruajtjen e konfidencialitetit të tyre.

Neni 5

Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet për një periudhë 1 (një) vjeçare me të drejtë ripërtëritjeje me të njëjtin afat, nëse palët nuk shprehen në të kundërt përpara mbarimit të afatit.

Neni 6

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet e lindura ndërmjet Palëve në lidhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen me mirëkuptim mes palëve.

Neni 7

Përfundimi i Marrëveshjes

1. Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje përpara afatit të përcaktuar në nenin 5, duke njoftuar palën tjetër me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të afatit të Marrëveshjes, duke dhënë sqarime të hollësishme mbi këtë ndërprerje.
2. Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

Neni 8

Personat e kontaktit

1. Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjithë komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara, elektronike ashtu edhe të shtypura.
2. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, personat e kontaktit janë si vijon:
 - a) Për ASHDMF: Znj. Elona Halilosmani, Specialiste, me numër kontakti: 3554500329/0695721692 dhe adresë e-mail: Elona.Halilosmani@femijet.gov.al
 - b) Për QPKMR: Znj. Denisa Veliu, Përgjegjës Sektori, me numër kontakti Cel: 0696128782 dhe adresë e-mail: denisa.veliu@drejtesia.gov.al.
3. Këta persona do të jenë përgjegjës gjithashtu për saktësinë e protokolleve, procesverbaleve dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm.
4. Në rast të ndryshimit të njërit nga këta persona, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi, duhet të sigurohet që të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 5 (pesë) ditësh, për të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të saj.

Neni 10
Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje hartohet në katër kopje të barasvlershme, nga dy kopje për secilën palë, të firmosura nga titullarët dhe të vulosura me vulat zyrtare të institucioneve palë.
2. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

PËR
AGJENCINË SHTETËRORE PËR
TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E
FËMIJËS

KRYETAR
Alma TANDILI

PËR
QENDRA E PARANDALIMIT TË
KRIMEVE TË TË MITURVE DHE
TË RINJVE

DREJTOR
Kludia HASANLLARI
